Ju tërheqim vëmendjen se me qëllimin e mbylljes mujore pa probleme, në çdo muaj, porositë e ardhura me postë pas datës 25, zyra jonë i dërgon ato vetëm në fillim të muajit të ardhshëm, kështu që edhe pikët e kreditit që u përkasin atyre i shënojmë në muajin e ri.

### NJOFTIMET E ZYRAVE TË SERBISË:

Forever Living Products Beograd na ofron shërbimet e mëposhtme: bëje porosish në telefon - telecenter. Të gjitha mallet mund ti porosisni në numrin e telefonit: 011/309-6382. Orari i punës së Telecenterit dhe zyrës së Beogradit: të martën dhe të enjten 12: 00-19.30, në ditët e tjera të punës 9:00-16.30. Në rastin e porositjes në telefon malli shkon tek adresa që gjendet në numrin e kodit. Malli paguhet gjatë marrjes së tij. Shpenzimet e postës paguhen sipas kursit të PTT Serbisë të ditës që ndodh shërbimi. Nuk mund të bëhet hyrje nëpërmjet telefonit. Në porositë me telefon marrim parasysh vetëm porositë e bëra deri në

datën 25 të muajit në fjalë, pas kësaj date porositë mund ti bëni vetëm personalisht në zyrat tona.

Edhe në zyrën e Horgosit dhe Nisit mund të blihen materiale reklamash dhe gjithë llojet e formularëve. Distributorët tanë mund të blejnë edhe fletat e regjistrimit dhe formularët për ndryshimin e të dhënave. Dita jonë e ardhshme e Suksesit Forever do të mbahet më 23 shtator 2006.



Zyra e Beogradit

### NJOFTIMET E ZYRAVE TË BOSNIA-HERCEGOVINËS:

Në zyrat e Forever Living Products të Bosnias, porositë telefonike mund të bëhen në numrat e mëposhtëm (regjistrimi i shpërndarësve të rinj nuk mund të bëhet nëpërmjet telefonit): Bijeljina: 055/211-784. Orari i hapjes në ditët e punës: 9.00-16.30 Sarajevo: 033/760-650. Orari i hapjes në ditët e punës: 9.00-16.30. Të mërkurën: 12.00-20.00 Në rastin e porosisë telefonike, pagesa bëhet kur merret malli. Nëse vlera e porosisë nuk e kalon vlerën e një pike, atëherë transportimin në shtëpi e paguan shpërndarësi.

Adresa e re e zyrës së Bijeljinës: FLP-Bos Bijeljina, Trg Đenerala Draže Mihajlovića br. 3, 76300 Bijeljina. Tel: 055/211-784, 055/212-605, fax: 055/221-780.

Adresa e qendrës së Banja Lukës: Duško Koščica u. 22. Tel: +387-51-228-280, fax: +387-51-228-288

### NJOFTIMET E ZYRËS SË KROACISË:

Njoftojmë konsumatorët dhe distributorët tanë se zyra e FLP-ë së Zagrebit gjendet në adresën Grada Mainza 21. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00; të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-

17.00. Tel.: +385-1-3909-770 dhe fax.: +385-1-3909-771. Porosia telefonike bëhet në numrin +385-1-3909-773. Nëse vlera e porosisë është më e madhe se 1 pikë, shpenzimet e transportit i paguan FLP-ja. Leksionet rreth marketingut dhe produkteve fillojnë çdo të hënë dhe të enjte në orën 18.00 në zyrën qendrore.

Ju njoftojmë mëtej se zyra jonë e Splitit gjendet në adresën Križine 19. Tel.: +385-21-459-262. Orari i hapjes: të hënë 12.00-20.00; të martën, të mërkurën, të enjten dhe të premten 09.00-17.00.

## NJOFTIMET E ZYRËS SË SLLOVENISË:



**Zyra e Lendvait**

Ju njoftojmë se orari i hapjes së magazinës sonë në Trzin është: të hënë dhe të enjten 12.00-20.00, të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00. Ky orar hapje është i vlefshëm edhe në rastin e porosive telefonike. Numri i Telecenterit (ku bëhen porositë telefonike) është: 01/563-7501

Adresa e magazinës së Lendvai-t: Kolodvorska 18, 9220 Lendva  
Tel.: +386-40-955-167.

## Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Hungarisë:

Dr. Gabriella Kassai: +36-30-307-7426  
Dr. György Bakanek: +36-20-944-1442  
Dr. Laszlo Kerekes: +36-20-944-1442  
Dr. László Mezôsi: +36-20-552-6792.

## Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Kroacisë:

Dr. Ljuba Rauski Naglic: +385-915176510  
Dr. Eugenija Sojat Marendic: +385-915107070

## Serbiai orvos szakértőink telefonszáma:

Dr. Biserka Lazarevič és Dr. Predrag Lazarevič: +381-23-543-318

## Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Sllovenisë:

Dr. Arbaiter Miran: +386-41420788  
Dr. Canzek Olga: +386-41824163

## Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Malit të Zi:

Dr. Laban Nevenka: +381-69-327-127

# FLP TV

## Në internet

[www.flpseeu.com](http://www.flpseeu.com)

### PROGRAMI

Nga 17 korrik deri më 20 gusht 2006

- 10.00 **Lajme**
- 10.05 **Nga bima deri tek produkti**
- 10.18 **Dita e Jonathan-it** – Istvan Darabos  
**Cote D'Azur** – fotografi
- 10.40 **Conquistador Club**
- 11.45 **Film prezantues produktesh** – Probiotic  
**Houston** – fotografi
- 12.00 Rolf Kipp – Metoda pune
- 12.40 **Dita e Jonathan-it** – Nikoletta Pal
- 13.00 **Takim managerësh 2005** – Szirak
- 13.35 **FLP – Plani Marketing**
- 13.55 **Dita e Jonathan-it** – Dr. Edit Revesz Siklosne
- 14.15 **Profit Sharing 2006**
- 15.40 Katrin Bajri 1.
- 17.05 **Film prezantues produktesh** – Përrallë shampoje
- 17.10 **Dita e Jonathan-it** – Dr. Terezia Samu
- 17.30 Tonk Emil – Si profesionist apo si amator
- 18.00 **Lajme**
- 18.05 **Nga bima deri tek produkti**
- 18.18 **Dita e Jonathan-it** – Istvan Darabos  
**Cote D'Azur**
- 18.40 **Kualifikime**
- 19.45 **Film prezantues produktesh** – Probiotic  
**Houston** – fotografi
- 20.00 Rolf Kipp – Metoda pune
- 20.40 **Dita e Jonathan-it** – Nikoletta Pal
- 21.00 **Takim managerësh 2005** – Szirak
- 21.35 **FLP – Plani Marketing**
- 21.55 **Dita e Jonathan-it** – Dr. Edit Revesz Siklosne
- 22.15 **Profit Sharing 2006**
- 23.40 Katrin Bajri 1.
- 01.05 **Film prezantues produktesh** – Përrallë shampoje
- 01.10 **Dita e Jonathan-it** – Dr. Terezia Samu
- 01.30 Tonk Emil – Si profesionist apo si amator
- 02.00 **Lajme**
- 02.05 **Nga bima deri tek produkti**
- 02.18 **Dita e Jonathan-it** – Istvan Darabos  
**Cote D'Azur**
- 02.40 **Conquistador Club**
- 03.45 **Film prezantues produktesh** – Probiotic  
**Houston** – fotografi
- 04.00 Rolf Kipp – Metoda pune
- 04.40 **Dita e Jonathan-it** – Nikoletta Pal
- 05.00 **Takim managerësh 2005** – Szirak
- 05.35 **FLP – Plani Marketing**
- 05.55 **Dita e Jonathan-it** – Dr. Edit Revesz Siklosne
- 06.15 **Profit Sharing 2006**
- 07.40 Katrin Bajri 1.
- 09.05 **Film prezantues produktesh** – Përrallë shampoje
- 09.10 **Dita e Jonathan-it** – Dr. Terezia Samu
- 09.30 Tonk Emil – Si profesionist apo si amator

# FOREVER



## Sonya® Color Collection



# Prospekt i Qendrës Mësimore dhe të Shërbimit Sonya

I njoftojmë me kënaqësi gjithë lexuesit e dashur se më 5 qershor 2006 hapim Qendrën Mësimore dhe të Shërbimit Sonya në Budapest, në rrugën Sondi 34, në katin e parë të qendrës së FLP Hungari Shpk. Në qendrën tonë punonjës specialist presin paraqitjen e atyre që zotërojnë kartë blerje me shumicë. Gjatë përgatitjes së makijazheve përdorim produktet e Sonya Colour Collection. Kjo është familja e vetme në botë e produkteve kozmetike me bazë aloe vera-n, e cila kombinon lëndët kozmetike zbukuruese me kujdesin për paraqitjen e jashtme. Sonya është kombinimi special i përbërësve natyror – si përshembull Aloe Vera e pastër, vitamina antioksidante, ekstrakte deti ose kamomil – të cilat sigurojnë mbrojtjen, kujdesin dhe trajtimin e lëkurës sonë. Ky koleksion i shkëlqyer nxjerr në pah gjithë nuancat e ngjyrave në përputhje me tonin e lëkurës, si dhe me gjendjen tonë shpirtërore.

## TRAJTIME KOZMETIKE

### Lulja e rinisë: trajtim prej afërsisht 50 minutash

Pastrim: Aloe Eye Makeup Remover, Exfoliating Cleanser  
Heqja e qelizave epiteliale të vdekura: Forever Aloe Scrub  
Fshirja e fytyrës: Rehydrating toner  
Vendosja e maskës: Facial Contour Mask Powder dhe Aktivator  
Pas larjes: Rehydrating toner  
Krem ditor: Firming Foundation Lotion

### Luftë kundër rrudhave: trajtim prej afërsisht 50 minutash

Fshirja e hijes së syve: Aloe Eye Makeup Remover  
Fshirja e grimit: Exfoliating Cleanser  
Fshirja e fytyrës: Rehydrating toner  
Lagia e zonës së syve me Aktivator;  
Vendosja në këtë zonë e Forever Alluring Eyes  
Përzierja dhe vendosja e R-3 Faktor dhe Alpha E factor në fytyrë dhe në qafë

Vendosja e Maskës së përthithur me Aktivator  
Pas heqjes së maskës fërkimi i lëndëve vepruese të mbetura në fytyrë

### Magjia e detit: trajtim prej afërsisht 50 minutash

Fshirja e hijes së syve: Aloe Eye Makeup Remover  
Fshirja e grimit: Exfoliating Cleanser  
Heqja e qelizave epiteliale të vdekura: Forever Aloe Scrub  
Fshirja e fytyrës: Rehydrating toner  
Vendosja e Forever Marine Mask  
Pas larjes: Rehydrating toner  
Krem ditor: Firming Foundation Lotion

### Hidratim i thellë: afërsisht 50 minuta

Fshirja e hijes së syve: Aloe Eye Makeup Remover  
Fshirja e grimit: Exfoliating Cleanser  
Heqja e qelizave epiteliale të vdekura: Forever Aloe Scrub  
Fshirja e fytyrës: Rehydrating toner  
Përzierja dhe vendosja e Aloe Moisturizing Lotion dhe Alpha E factor në fytyrë  
Vendosja mbi këtë e Maskës së përthithur me Aktivator  
Fërkimi i kremit të mbetur duke i hedhur pak First

### Bombë gjallëruese: afërsisht 50 minuta

Fshirja e hijes së syve: Aloe Eye Makeup Remover  
Fshirja e grimit: Exfoliating Cleanser  
Heqja e qelizave epiteliale të vdekura: Forever Aloe Scrub  
Fshirja e fytyrës: Rehydrating toner  
Përzierja dhe vendosja e Recovering Night Creme dhe Alpha E factor në fytyrë

Vendosja mbi këtë e Maskës së përthithur me Aktivator  
Fërkimi i kremit të mbetur duke i hedhur pak First



## MASAZH:

**Masazhi freskues dhe relaksues suedez (afërsisht 1 orë):** Masazhi suedez është një teknikë masazhi gjatë të cilit në mënyrë mekanike përmirësojmë gjendjen e përgjithshme të muskujve. Efekti i tij: ushqimimi më i mirë i qelizave; lëkura bëhet më elastike; shkëputen qelizat epiteliiale të vdekura; shpijen muskujt; heq mpirjen dhe lodhjen e muskujve; ul dhembjen.

**Masazhi indian (afërsisht 1 orë):** Jep energji, ul stresin, qetëson. Si rrjedhim i tij ulen tensionet e grumbulluara, hapen dhe pastrohen chacra-t, ripërtërihen forcat vetëmjekuese.

**Masazhi thai (afërsisht 1 orë):** Masazhi thai nuk përqendrohet tek ana fizike, por tek ajo energjitike e trupit të njeriut. Shtypin pikët e energjisë, ose bëjnë shtypje të përgjithshme, përveç kësaj përmban edhe ushtrime tendosjeje. Masazhi i linjave të energjisë stimulon rrjedhjen e lirë të energjisë së jetës dhe ndihmon në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme shëndetësore.

**Masazhi i shputës (afërsisht 1 orë):** Ndikon në funksionimin e organeve. Si rrjedhim i tij përmirësohet qarkullimi i gjakut, gjendja shpirtërore, ulet tensioni nervor.

**Masazhi relaksues aromatik (afërsisht 1 orë):** Relaksim trupor dhe shpirtëror me vajra të avullueshme. Ka efekt ushqyes, rigjenerues dhe qetësues të lëkurës. Rrit elasticitetin e lëkurës.



## Masazh dobësues dhe celuliti (afërsisht 1 orë):

Si rrjedhim i tij lëkura bëhet më e tendosur. Ul celulitin, stimulon qarkullimin e gjakut, pastron lëkurën. Shpërbën lëngjet dhe lëndët helmuese të grumbulluara. Natyrisht në çdo lloj masazhi përdorim produktet e Forever-it: Aloe Body Toning Kit, Aloe Heat Lotion, Aloe Moisturizing Lotion, Aloe Body Toner, Aloe Body Conditioning Creme, Aloe Vera Gelly, Aloe Lotion, Aloe Propolis Creme, Forever Aloe Scrub, Alpha-E Factor, First.

Shërbimet profesionale i ofrojmë me një çmim tepër të favorshëm, por vetëm për punonjësit që zotërojnë kartë blerje me shumicë, në mënyrë që edhe nëpërmjet kësaj të njohin përsosmërinë e produkteve tona, të njohin teknikat e përgatitjes së makijazhit, dhe natyrisht të kalojnë një orë të këndshme me shpłodhje dhe relaksim në Qendrën tonë. Edhe kjo është një pjesë e rëndësishme që ta ndërtojmë biznesin me një vrull të ri, pasi duhet t'i japim organizmit tonë shpłodhjen dhe ushqimin e duhur, si dhe femrat e bukura të bëhen edhe më të mrekullueshme. Paraqitja dhe lënia e takimit bëhet në këtë mënyrë: në rastin e masazheve mund të paraqiteni tek Monika Vida në numrin e telefonit 20/4571155; për shërbimet kozmetike mund të paraqiteni tek Magdolna Darvas në numrin e telefonit 269-5370/124. Punonjësit e qendrës së re, masazhatorët Ildiko Hrcnjar dhe Csilla Fülöp, si dhe specialistja e kozmetikës Ildiko Meszaros, iu urojnë të gjithëve zbukurim, shpłodhje dhe relaksim.

Kata Ungar i pret mëtej ata që duan të zbukurohen të martën dhe të enjten nga ora 10 në Qendrën Mësimore.



**TIBOR ELIAS**

soaring manager  
anëtar i President's Club

**Kur njeriu arrin në majë të malit me një lodhje të këndshme dhe kënaqësi shikon prapa rrugën e bërë... e arrita edhe këtë. Ngjitja e disa kodrave të vogla nevojitet për arritjen e një maje mali më të lartë?! Shplodhet, merr frymë dhe i kënaqur deklaroi: nuk ishte aq e vështirë saç dukej në fillim. Kjo zgjati për tetë vjet...?! E mendon njëqind herë se si ishte, nga e çoi drejtimi i gabuar, çfarë pengesash i dolën, ku mund t'i binte më shkurt dhe cila rrugë mund të ishte më e lehtë dhe më e shpejtë. Natyrisht tani në fund çdo gjë është më e thjeshtë, dhe merr frymë thellë: po ta filloja nga e para çfarë do të bëja ndryshe...**

## “Kufiri është qielli me yje...!”

Po ta filloja sot. . . do ta merrja seriozisht! Do t'i besoja mundësitë dhe do ta pranoja rrugën e ofruar. Një mëz i egër pa fre kërkon pozicionin e tij në botë. Mund të bëjë ç'të dojë — ka energji dhe kohë —, s'ka detyrime, nuk po i digjet shtëpia, nuk i ka ardhur akoma koha! Pastaj krijon përvoja, zbulon, dhe nëse i dallon gabimet e tij, qëndron në radhë ose mbetet prapa. Dhe me dhembje, inat dhe zili thotë: të tjerët përse patën sukses?! . . . Por ka mëza të cilët edhe duke mbetur prapa e gjejnë rrugën tjetër që të çon në majë të malit, e cila ndoshta është më e vështirë, ndoshta kërkon më shumë kohë dhe energji, por nëse e çon drejt pikës synimit atëherë le ta zgjedhë atë rrugë. Ndoshta për të ajo është rruga ideale. Siç bëri edhe pulëbardha Jonathan, e cila nuk u kënaq me lartësinë e sigurt të fluturimit. E morri përsipër sfidën, rrezikun, luftoi dhe e arriti qëllimin e saj. . .

Shpeshherë më duket se mua kjo s'më mjafton, — dua të bëhem shqiponjë, të ngjitem akoma e më lart, të ndihmoj më shumë njerëz dhe të arrij më shumë suksese, sepse e di se “kufiri është qielli me yje. . .”!

Në majë të malit mund ngjitesh në disa drejtime. . . por prapël! Po ta filloja nga e

para do të ngjitesha shpejt në majë, sepse do të ecja në rrugën e shkelur nga Rex Maughan, e cila është përshkruar nga disa diamantë dhe safirë. Do t'i lija të gjitha ngarkesat dhe veprimet e tepërta, dhe do ta besoja atë që sot di, provoj dhe bëj të ditur, si dhe që jam me të vërtetë në pozicionin më të mirë në botë.

Do t'u shtrëngoja duart, do t'u ngjitesha nga pas dhe do të bëja me sy mbyllur atë që më thonë Ata, “alpinistët” me përvojë. Ata të cilët kanë arritur në majë. . . të cilët e kanë përshkruar rrugën e Rex-it. . . A e kishin të lehtë? Ata ishin nismëtarët, pothuajse pa asnjë pajisje. Kurse ne vetëm duhet t'i kopjojmë ata! Do të vihesh në radhën e shqiponjave që fluturojnë lart, do të besoja në forcën ngritëse dhe do të kërkoja mundësitë e fluturimit dhe navigimit të përkryer. Dhe do të ngjitesha edhe më lart se sa ka mundësi një zog. Nuk do të nxirra pretekste dhe do ta harroja shprehjen: më vonë. . . Nuk do të prisja erën dhe kohën e përshtatshme, sepse ato nuk vijnë asnjëherë dhe gjithmonë ekzistojnë dhe do të ekzistojnë “rrethana”. Dhe nëse jeta ndërmjet frutave të shumta të shijshme do të më jepte vetëm limonin, atëherë nuk do të thartohesha, por do ta bëja limonadë. . .!

Në rrugën time kisha në të dyja anët mundësi të shkëlqyera dhe tepër joshëse. Por atëherë ishte tepër e vështirë t'u bëje ballë tundimeve! Duke mësuar, vepruar dhe provuar gjithmonë e më shumë, përpara meje u hapën shumë "sekrete", në botën e FLP-së dhe në qenien e saj të thjeshtë e të pastër u njoha me sinonimin e suksesit. Dhe si përfundim arrita të mposht çdo tundim. E kuptova se këtë kam kërkuar gjatë gjithë jetës sime. Dhe këtu qëndrova. Dhe gjeta gjithçka që kisha ëndërruar. Sepse ëndrrat realizohen nëse i dëshiron shumë, përpiqesh me këmbëngulje dhe paguan çmimin e tyre!

Rikthim shëndeti, miq të rinj, sukses, pavarësi materiale, më shumë kohë të lirë. . . Jeta ime morri kuptim: ndihmë e dobishme dhe pavarësi! Dalëngadalë kuptova se në fillim duhet të ndryshoj vet që pastaj të mund të ndihmoj të tjerët. Edhe duke dhënë shembull mund të kem efekt tek shumë njerëz. Këtu ai që kërkon, gjen mbështetje trupore, mendore dhe shpirtërore. Vendi ynë ka nevojë për njerëz të ndershëm, të shëndetshëm, krijues, si dhe për milionerë dhe shtetas të kënaqur dhe të lumtur.

Në rrugë ka edhe udhëtarë të zhgënjyer, të lodhur e të prapambetur. Ata që ulen, ngrihen me vështirësi. . . Zona e rehatit, frika, paniku, idetë e gabuara, fokusimi i gabuar, mosbesimi, mungesa e qëllimeve, – një rrugë e vështirë! Dhe natyrisht ka nga ata që dorëzohen. Ka nga ata që të mashtrajnë dhe informojnë në mënyrë të gabuar. E sheh, edhe këtu ka profesionistë dhe të pazotë. Por sukcesi i sigurt varet vetëm nga fakti se kur je gati të marrësh në dorë fatin tënd dhe t'i paguash "çmimin". Mua m'u deshën pesë vjet derisa provova gjithçka,

por kjo nuk funksionon. U kënaqa me çerekun e kësaj, jetoja në zonën time të rehatit. Por tre vjet më parë më në fund shkruajta qëllimet e mia. . . dhe tani arrita një të pestën e rrugës sime të planifikuar!

Ka njerëz të cilëve u flet kot rreth udhëtimit tënd të mrekullueshëm në male, nëse ai dëshiron të shkoj në det. Por mos u dorëzo. Tregoji atij gjithçka. Tregohu krenar për vetveten dhe malet e tua. Ndoshta një ditë do të vijë me ty të ngjisë malet dhe do të bëhet pjesë e aventurës tënde.

Ashtu si ndihmësja dhe "udhërrëfyesja" ime, Dr. Maria Pavkovics, u bë shoqja më e rëndësishme dhe vendimtare e jetës sime gjatë 8 viteve të fundit. Po ta nisja sot, do ta kisha të lehtë, sepse nga ajo në "fushën e saj" mund të mësojnë gjenerata të tëra. Ai që dëshiron dhe "e paguan" me të vërtetë çmimin e pavarësisë dhe jetës së gjatë, të shëndetshme e të lumtur, e ka vendin mes nesh. Këtu falenderoj edhe "vëllezërit" më të mirë, skuadrën e Halmit për ndihmën e dhënë në Hortobagy.. Aranka Vagasi dhe familja e saj janë shembulli i teknikës, këmbënguljes dhe forcës. Njohuria, njerëzimi dhe miqësia e çiftit Czele, shembulli, instinkti luftëtar dhe shpirti madhështor i familjes Szabo, dhe profesionizmi i Njeriut të Madh Miklos Berkics krijuan karakterin, personalitetin dhe pjekjen time si drejtues. Drejtimi elastik, problemëzgjdhës dhe me nivel të lartë i Dr. Sandor Milesz, sjellja njerëzore dhe ndihmëdhënëse e Peter Lenkey-t. . . dhe do të rradsija këtu anëtarët e shumtë të skuadrës me të cilët është gjithmonë një ndjenjë e mirë të punosh së bashku. Me shumë prej tyre i bihem

me të vërtetë rrotull botës me ndihmën e FLP-së. Për mua nuk është ngarkesë, por një "vizitë miqësore" të shkoj në magazinë ku pritem nga një "skuadër e mirë". Zyrë dhe magazinë – kuzsinë dhe dhomë ndënjeje. Edhe kopshti dhe kopshtari më sjell ndër mend shtëpinë ideale. Prandaj shkoj të fle në shtëpi ku më pret shoqja dhe frymëzuesja ime: Marianne Szasz. Ajo që në fillim ishte kundër FLP-së (edhe atë e informuan keq dhe nuk e ndihmuan) u bë specialiste e ndërtimit të rrjetit. I treguam rrugën e Rex-it! Dhe sot ajo është ndjekësja më e mirë e kësaj rruge. Faleminderit!

Kur njeriu arrin në majë të malit me një lodhje të këndshme dhe kënaqësi shikon prapa rrugën e bërë. . . Dhe duke parë rrotull shikon male edhe më të larta, mundësitë e mëdha që i konsideron si sfidë. Tani nuk kam frikë t'i vihem një rrugë të gjatë, një lartësie marramendëse, sepse si ndjekës i mirë e di se kë rrugë duhet të zgjedh. Ngjitem lart me pesë shqiponja të fuqishme: pesë drejtuesit e mi kryesor Gloria Geszty, Roland Szabo, Marianne Szasz, Maria Szalkai dhe dr. Edit Wohlmut me bashkëshortin e saj, dr. Gyula Wirth. Si dhe me grupin e zogjve Iren Kilian dhe Veres Zoli. Dhe ata ndiqen nga pulëbardhat kryesore: Laszlo Harrer, Iren Kassai, Meszaros Benőne, çifti Schuszter, Balazs Laibl, Jolika Szenttamasi, Jozsef Raduly, Lori Hlavathy, Marika Fabos, Klari Meresz, çifti Seres, si dhe të tjerët në thellësi të cilët mund të ngjiten kurdo lart si shqiponja. Ata që na ndjekin në rrugën e përshkuar, priten nga një jetë e larmishme, e bukur dhe e suksesshme.

Pra, do të fluturon (soaring) me ne. . .! Parrulla jonë është: Kufiri është qielli me yje!



## Biznesi Forever: Pikët personale dhe jo-manageri

### ***Në çfarë gjendje është rrjeti im?***

Nëse dëshironi të dini se në çfarë gjendje është zemra juaj, duhet të bëni në analizë të hollësishme kardiogrami. Në të njëjtën mënyrë, nëse dëshironi të dini gjendjen e rrjetit tuaj, duhet studioni me hollësi llogaritë e bunuseve.

Hidhini një sy fundit të llogarisë, ku gjeni të gjitha **pikët tuaja personale dhe jo-manageri**. Tregon rritje?

Si është në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar? Nëse tani afër arritët të bënit një manager të ri, pikët tuaja me siguri bien me një farë vlere, pasi qarkullimi i managerit tuaj të ri nuk iu llogaritet si më parë. Po

a fillon të rritet përsëri vlera e pikëve tuaja? E rëndësishme është që pikët e non-managerit të jenë gjithmonë të paktën rreth 50, kjo është shenja e sigurt e faktit se rrjeti juaj po rritet. Nëse kjo vlerë ulet shumë, atëherë të jeni të sigurt se biznesi juaj po bie, prandaj erdhi koha ta riorganizoni biznesin tuaj.

### **Pikët personale dhe jo-manageri**

janë tepër të rëndësishme përsa i përket rritjes dhe stabilitetit të biznesit tuaj. Këto janë pikët që vijnë nga qarkullimi personal dhe i bashkëpunonjësve që nuk u përkasin manageri tjetër.

*Bill Lewis: Your FLP Business  
In Forever International  
March 2006/issue 60.  
PP. 20-21.*

Nëse Ju nuk keni manager në skuadrën tuaj, çdo pikë që bëni është personale dhe jo-manageri, prandaj 100% e punës sjell rritjen e këtyre. Por kur ju lind manageri i parë duhet të mësoni ta ndani mirë kohën. Është tepër e rëndësishme t'i mbështesni mëtej managerët e rinj, por është gjithashtu e rëndësishme t'iu mbetet kohë e mjaftueshme edhe për mbështjetjen e mëtejshme të jo-managerëve.

Kjo veprimtari është e njëjtë me atë të mëparshmen: kërkimi dhe mbajtja e konsumatorëve, kërkimi dhe sponsorizimi i distributorëve të rinj, dhe mbështetja e tyre në shkallët e sistemit të shpërblimit. Kur një punonjës bëhet manager, duhet të ketë aftësinë që të bëhet drejtues i skuadrës së vet, që t'i mbështesë bashkëpunonjësit e tij siç e mësoi nga Ju. Pas kësaj Ju do të keni më shumë kohë për të mbështetur skuadrën tuaj.


Sponsorizimi dhe ndërtimi i skuadrës janë elementët më të rëndësishëm të biznesit, prandaj skuadra, si dhe aktiviteti 4 pikësh që të jep të drejtën për të marrë bonus drejtuesi, nga niveli i Supervisorit janë tepër të rëndësishme.

Sponsorizimi siguron rritjen e biznesit. Sponsorizimi nuk do të thotë vetëm sjelljen e njërezve të rinj në biznes. E rëndësishme është t'i përgatisim, t'i mbështesim dhe t'i ndihmojmë vazhdimisht ata në shkallët e planit marketing. Kjo përbën pikët tona personale dhe jo-manageri.

Zhvillimin e skuadrës e pasqyron mirë analogjia e mëposhtme: imagjinojeni biznesin tuaj sikur vozisni në një varkë bashkë me punonjësit tuaj. Kur një distributor arrin nivelin e managerit, bashkë me skuadrën e tij ulet në një varkë tjetër dhe vozisin së

bashku mëtej. Nëse nuk keni mjaft bashkëpunonjës jo-manager, pas kësaj do ta keni të vështirë të ecni përpara. Imagjinoni sikur të gjithë bashkëpunonjësit tuaj të bëhen manager, zbrisin nga varka juaj dhe vozisin mëtej me skuadrën e vet varkën e tyre, atëherë Ju vetëm me siguri do të mbeten prapa. Natyrisht mund të mbroheni me faktin se nuk patët kohë të sponsorizoni distributorë të rinj sepse duhet të ndihmonit managerët tuaj, por prapë rezultati do të jetë që ju mbeten prapa (nëse managerët tuaj nuk janë mjaft të pavarur, atëherë nuk janë përgatitur në mënyrën e duhur për t'u bërë drejtues...!).

Pra, nëse keni si qëllim një biznes të shëndetshëm dhe në rritje, bonuse që shtohen vazhdimisht dhe të ardhura stabile, atëherë përqëndrohuni tek varka juaj!



# FOREVER HOLIDAY

## Split/Trogir, Croatia

**Forever Living Products International e kontrollon dhe mbështet vazhdimisht punën rrjetndërtuese të punonjësve të saj, dhe e ndihmon me një kujdes të veçantë zhvillimin e punonjësve të rinj të cilët nisen në rrugën e popullarizimit të produkteve Forever.**

Zyra Qëndrore e Forever-it krijoi për distributorët hungarez dhe sllavo-jugor të Forever Living Products Programin Motivues Forever Holiday i cili e bën edhe më të vullshëm ndërtimin e rrjetit nga punonjësit e rinj dhe i shpërblen pjesëmarrësit e këtij programi motivues.

### ***Kushtet e Programit Motivues janë:***

1. Në **Programin Motivues** mund të marrin pjesë të gjithë punonjësit e rinj vendas të regjistruar në 1 qershor ose më pas të vitit të Programit Motivues (2006), të cilët i kanë plotësuar kushtet për t'u bërë distributor (pra në rastin konkret në këtë program mund të marrin pjesë **distributorët e rinj vendas të regjistruar pas datës 1 qershor 2006.**)
2. Programi Motivues Forever Holiday fillon nga 1 qershori dhe përfundon më 31 gusht të të njëjtit vit.
3. Distributori gjatë qershorit, korrikut dhe gushtit duhet të arrijë të paktën nivelin e supervisorit. Distributori në çdo muaj të kualifikimit duhet të bëjë një aktivitet prej 4 pikësh (duhet të jetë aktiv që nga muaji i parë i plotë, por natyrisht nëse regjistrohet në gusht, atëherë duhet të jetë aktiv edhe në gusht.)
4. Nëse në një linjë sponsorizimi non-manageri në një muaj kualifikohen disa supervisorë, atëherë në udhëtim

mund të marrë pjesë distributori i parë që e arriti nivelin e supervisorit.

Në programin motivues mund të marrë pjesë distributori i kualifikuar dhe bashkëshorti/bashkëshortja e tij. Kompania u paguan shpenzimet e udhëtimit, pjesëmarrjes dhe fjetjes.

### ***Programi:***

#### **29 shtator 2006, e premte**

nisje me autobus për në Trogir të Kroacisë  
Banket (vetëm për të kualifikuarit/lektorët)

#### **30 shtator, e shtunë**

mëngjes në hotel  
nga ora 9:00 trainim nga Supervisor në Manager (mësim, metoda pune, Turbo Start) në Split  
reth orës 13-13.30 drekë me pritje në këmbë  
13.30-15.45 kurs përgatitor  
pas orës 16 shpërndarje  
nga ora 19 Beach Party, dhënia e diplomave  
(mund të marrin pjesë edhe ata që paguajnë)

#### **1 tetor, e djelë**

mëngjes në hotel  
reth orës 11 kthim me autobus

### ***Blerja e biletave:***

Distributorët e pakualifikuar mund të blejnë bileta në numër të kufizuar.

Ky kurs përgatitor u rekomandohet supervisorëve.  
Mund të blihen dy lloj biletash:

- biletë kursi
- biletë Rally (kurs + fjetje)

# DAY RALLY 2006

**Merrni pjesë edhe Ju në Rally-n  
Forever Holiday të sivjetshëm, në  
bregdetin e mrekullueshëm kroat!!!  
Split/Trogir, 29. 09–01.10. 2006**

[www.flpseeu.com](http://www.flpseeu.com)





**DR. MARIA FABIAN**  
managere

**E konsideroj gjithmonë të rëndësishme njohjen e funksionimit të organizmit tonë, pasi kështu bëhet më e qartë se përse dhe me çfarë mund të arrijmë rezultate në ruajtjen e shëndetit tonë. T'i sqarojmë pak përkufizimet!**

## Antioksidantët

**Antioksidantë** quajmë lëndët që gjenden në ushqime, me të cilat organizmi asgjeson oksidantët në qeliza.

Këto molekula krijohen gjatë procesit normal të metabolizmit dhe dëmtojnë qelizat dhe indet nëse për shkak të ndonjë sëmundje, lëndëve helmuese (ilaçe, alkool, drogë!), plakjes apo banjës së tepërt të diellit sasia e tyre në organizëm rritet.

Ngarkesa fizike, mendore dhe shpirtërore e rrit krijimin e oksidantëve.

**Oksidantët** hyjnë shpejt në reaksion me molekulat që gjenden pranë tyre dhe i dëmton ato duke u ndryshuar strukturën – oksidohen – gjë e cila ndikon në funksionimin e tyre.

*Efektet e dëmshme të oksidantëve:*

- dëmtojnë lëndën trashëguese në bërthamën e qelizës dhe sjellin si pasojë krijimin e anomalive të vetëlindura dhe sëmundjeve kanceroze.
- kolesterolin e ndodhur në gjak për shkak të oksidimit futet dhe depozitohet në muret e enëve të gjakut.
- krijohet katarakta
- vihen re probleme imunitare

- pezmatohen kyçet
- vihet re një plakje e parakohëshme

### **Roli i antioksidantëve:**

Organizmi i njeriut krijon edhe vetë lëndë me efekt antioksidant të cilat asgjesojnë efektet e oksidantëve. Përbërësit e vitaminave, lëndëve minerale dhe ushqimeve me origjinë bimore janë të rëndësishme edhe në këtë aspekt, prandaj për qëllim të ruajtjes së shëndetit është e rëndësishme marrja e këtyre në organizmin tonë.

Antioksidantët i asgjesojnë oksidantët në mënyrë natyrore. Rikthehet funksionimi i qelizave, zhduken simptomat, dhe qelizat dhe indet e kryejnë siç duhet detyrën e tyre.

Cili është pozicioni i antioksidantëve? Cilat lëndë mund t'i konsiderojmë si antioksidant?

### **Këto mund t'i ndajmë në katër grupe të mëdha.**

#### *1. Vitaminat*

Vitaminat D, K, B dhe vitaminat me efekt antioksidant **C, E, A**



**Vitamina C** duhet të merret në sasi më të madhe nga ata që përjetojnë stres, pijnë ilaçe dhe duhan. Mbron kundër kancerit, ruan kyçet, tendinat dhe muskujt, përforcon muret e kapilarëve dhe ndihmon në parandalimin e rrufës. Me marrjen e saj mund të ulim ndjenjën e lodhjes.

**Vitamina E** është "vitamina e rinisë". Rrit qëndrueshmërinë e organizmit, zbut lodhjen. Ndihmon në parandalimin e aborteve, pengon krijimin e trombozës. Së bashku me vitaminën A mbron mushkrinë nga efektet e dëmshme të ndotjes së rrugëve të frymëmarrjes, si dhe pengon oksidimin e acideve lyrore

me lidhje dyfishe, vitaminës C dhe selenit në organizëm. Pengon procesin e atrofizimit të muskujve dhe shkatërrimin e rruazave të kuqe të gjakut.

Vitamina A përmirëson shikimin, ruan shëndetin e lëkurës, flokëve dhe thonjve. Rrit qëndrueshmërinë e mukozës së rrugëve të frymëmarrjes.

E rrit në mënyrë të konsiderueshme aftësinë mbrojtëse të organizmit kundër infeksioneve.

## 2. Lëndët minerale

Organizmi i shëndetshëm ka nevojë për 60 lloje, nga këto 22 janë të

domosdoshme, 7 makro- dhe 15 mikroelementë.

Psh: Kalcium, Fosfor, Jod, Hekur, Magnez, Kalium, Krom, Molibden dhe ata me efekt antioksidant, **Selen, Mangan, Cink, Bakër.**

Do të theksoja **selenin** i cili mbron kundër kancerit, pasi përgjigjet edhe për tërësinë e lëndës trashëguese (ADN). Seleni ka më shumë efekt në prani të vitaminës A dhe E.

Lëndët minerale me efekt antioksidant mund të merren nëpërmjet produkteve natyrore që përmbajnë lëndë minerale,



multivitaminave, konsumimit të bimëve të gjelbëra dhe produkteve që mbrojnë sytë.

### 3. Bimët mjekësore

Ushqimin tonë ta plotësojmë me konsumimin e bimëve të ndryshme mjekësore. Këto shërbejnë parandalimin e problemeve dhe simptomave të ndryshme. Psh. efekti i boronicës, trumzës, ginzengut dhe i hudhrës njihet në masë të gjerë.

Bimët me efekt antioksidant përmbajnë substanca biologjikisht aktive me të cilat mund arrijmë rezultate të konsiderueshme në ruajtjen e shëndetit. Madje sipas përvojës sonë ato mund të përdoren edhe për përmirësimin e sistemit imunitar, si dhe në mbrojtjen kundër sëmundjeve inflamative dhe infeksioneve të shpeshta.

Një nga sëmundjet kryesore të kohës sonë është kanceri. Bimët mjekësore me efekt antioksidant si psh.: aloe vera, fruti lycium, ginkgo biloba, shega dhe mangostani luajnë një rol të madh edhe në parandalimin dhe luftën kundër kancerit.

Me konsumimin e këtyre frutave dhe perimeve i sigurojmë organizmit tonë një mbrojtje të madhe. Bimët mund t'i sigurojmë dhe konsumojmë në forma të ndryshme pijesh dhe produktesh.

4. Në të ashtuquajturën kategoria *tjetër* radhisim lëndë tepër të nevojshme për organizmin tonë të cilat nuk marrin pjesë në kategoritë e mësipërme. Të tilla janë psh.: vaji i peshkut, grupi i baktereve normale të zorrëve, aminoacidet si elementët përbërës të proteinave, **substancat fito (psh. flavonoidet, xantonet), Q10.**

### Substancat fito (psh. flavonoidet)

janë molekula natyrore, biologjikisht aktive që gjenden tek bimët.

Sipas përvojave tona ato stimulojnë funksionin e sistemit imunitar, ulin krijimin e trombozës, rregullojnë nivelin e kolesterolit dhe hormoneve, stimulojnë funksionimin e qelizave të mëllçisë, duke përmirësuar në këtë mënyrë funksionin detoksikues.

Përmbajtje të lartë flavonoidesh kanë agrumet, manaferra dhe boronica. Prandaj përdorini pa frikë për parandalimin e problemeve të mësipërme dhe si plotësim i trajtimit mjekësor për zbutjen e simptomave.

**Q10** është një element përbërës i veçantë i qelizave tona. Kjo është lëndë që "ndihmon funksionimin e enzimave" në proceset metabolike që janë në funksion të vazhdueshëm. Këto janë sistemi i qarkullimit të gjakut, sistemi imunitar dhe sistemi nervor, të cilët punojnë për 24 orë me radhë. Natyrisht çdo qelizë e jona ka nevojë për këtë lëndë, por në këto sisteme është veçanërisht e rëndësishme.

Mund ta plotësojmë vetëm, por mund ta marrim edhe së bashku me bimë të tjera mjekësore. Në këtë mënyrë e ndihmojmë shumë sistemin e qarkullimit të gjakut dhe atë nervor.

*Duke e përmbledhur përveç disa vitaminave dhe lëndëve minerale, shumë bimë mjekësore dhe fruta kanë efekt antioksidant.*

Ju thërras vëmendjen se informacionet e dëgjura këtu nuk rrjedhin nga

Departamenti Shetëror i Farmacisë. Dhe nuk janë as udhëzime terapie në praktikën mjekësore!

Këto janë përvoja të mbledhura prej dhjetra e qindra vitesh, dhe të siguruara edhe në mjedisin tim rrethues rreth lëndëve të ndryshme të gjetura në natyrë.

## FOREVER

### Botuese:

Kompania Forever Living Products, Hungari.

### Redaktoi:

FLP Magyarország Kft.  
1067 Budapest, Szondi u. 34.  
Telefon: (36-1) 269-5373  
Fax: (36-1) 312-8455

### Redaktori kryesor:

Dr. Milesz Sándor

### Redaktor:

Kismárton Valéria, Petróczy Zsuzsanna,  
Pósa Kálmán

### Përgatitja për shtypje:

Tipofill 2002 kft.

### Shtypi:

Veszprémi Nyomda Zrt.  
U përgatit në 48 750 kopje

### Fotografitë e kopertinës:

Dr. Milesz Sándor

Për përmbajtjen e artikujve shkruarit mbajnë përgjegjësi!  
Çdo e drejtë mbrohet!

### Përkthyes, redaktues:

*shqip:* Dr. Marsel Nallbani  
*kroat:* Darinka Aničić, Anić Antić Žarko  
*serb:* Tóth-Kása Ottília, Molnár Balázs,  
Meseldžija Dragana  
*sloven:* Novak Császár Jolanda,  
Eurotranslate Ljubljana

# HOTEL KASTÉLY SZIRÁK



## Kampime verore me kuaj në Hotelin e Kështjellës së Szirakit

Me fillimin e pushimeve verore shpallim përsëri mundësinë e paraqitjes në kampimin me kuaj tepër popullor tashmë prej më shumë se dhjetë vitesh. Regjistrimi mund të bëhet në datat e shënuara më poshtë në numrin e telefonit 06-32-485-300. 25.06 – 01.07., 02.07 – 08.07., 09.07 – 15.07., 16.07 – 22.07., 23.07 – 29.07., 30.07 – 05.08.2006.

**Përshkrimi i kampimit:** Kampimi zhvillohet në cikle një javore në pjesën e turistave të Hotelit të Kështjellës së Szirakit, si dhe në arenën e kuajve të tij. Pjesëmarrësit e kampimit me kuaj janë fëmijë të moshës 9–16 vjeç. Fjetja e tyre sigurohet në pjesën e turistave të sipërpërmendur në dhoma me 2-3 krevatë. Dhomat kanë lavaman me ujë të ftohtë, kurse në çdo kat gjenden dushe të përbashkëta për pjesëtarët e kampimit.

Ciklet fillojnë gjithmonë të djelën, pjesëmarrësit duhet të mbërrijnë në kështjellë në mëngjes ndërmjet orës 8-12. Fëmijët priten nga kujdestarë, të cilët i marrin ata në dorëzim nga prindërit. Kampimi fillon në drekë. Kalorësimi për ata fillon që ditën e parë (të djelë pasdite). Në këtë ditë matin

njohuritë dhe aftësitë e fëmijëve në kalorësim dhe këtu vendoset se cili fillon me kalorësim në terren dhe cili në vathë.

Kalorësim ka dy herë në ditë, paradite dhe pasdite. Në periudhën e ndërmjetme me fëmijët merren kujdestarët. Kampimi merr fund të shtunën në mëngjes (mëngjesi është e ngrëna e fundit). Për fëmijët duhet ardhur deri në orën 10.00.

Hoteli siguron tre të ngrëna në ditë, kujdestarë për fëmijët, kurse në stallë trainerë të specializuar. Kampimet i nisim në rastin e paraqitjes së të paktën 15 personave! Pranojmë edhe çeqe pushimi!

Çmimi i kampimit me kuaj një javor së bashku me trainerët, kujdestarët dhe shërbimin e plotë nga e djela deri të shtunën është: 44.900 Ft, i cili përmban edhe tvsh-n.

Shpresoj që oferta jonë t'ua fitojë pëlqimin dhe+ presim sa më shpejt paraqitjen tuaj.





*Senya*<sup>®</sup>  
Color Collection

FOREVER LIVING PRODUCTS